



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin European

PROCESVERBAL

Tiranë më 09.09.2019, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të datave 04.09.2019, 08.09.2019 dhe 09.07.2019.
2. Miratimi i kalendarit të punimeve të Komisionit për Integrimin European për periudhën 2-20 shtator 2019.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet e vitit 2017”.
4. Çështje të tjera

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Taulant Balla, Ralf Gjoni, Arben Kamami Sadri Abazi, Klodiana Spahiu, Mirela Kumbaro, Nikolin Staka.

Mungojnë:

Fatmir Velaj dhe Ilirjan Pendavinji.

Të ftuar:

Armand Skapi – Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme
Elkana Himçi – Specialiste në Drejtorinë e Fondeve të Bashkimit European në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

Ada Shkurtaj – Specialiste në Drejtorinë e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Rudina Hajdari – Mirëdita të gjithëve!

Sot në rendin e ditës kemi tri çështje: miratimin e procesverbaleve të datave 4.07.2019, 8.07.2019 dhe 9.09.2019, që janë aspekt administrativ i Komisionit për Integrimin European, si dhe shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit European për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri – Kosovë 2014-2020, alokimet e vitit 2017”. U kërkojmë ndjesë zotit Skapi dhe specialisteve, zonjave që kanë ardhur, por fillimisht do të procedojmë me miratimin e procesverbaleve dhe më pas të kalendarit të punimeve të komisionit.

Gjatë kësaj periudhe Komisioni i Integritit ka bërë një punë voluminoze, ndaj do të doja që nënkryetarja e komisionit të na bënte një bilanc se çfarë ka ndodhur gjatë kësaj periudhe.

Zonja Mesi, fjala është për ju.

Senida Mesi – Përshëndetje!

Duke shfrytëzuar momentin e mbledhjes së parë të Komisionit për Integrimin European në këtë sesion të ri, menduam se do të ishte e udhës që të shihnim pak rrugëtimin në lidhje me seancat dhe të gjitha takimet që kemi zhvilluar në sezonin e mëparshëm, si dhe të dakordësojmë dhe të miratojmë kalendarin e këtij sesioni, jo vetëm kalendarin trijavor, por edhe të gjitha planet e tjera, të cilat i kemi dakordësuar dhe duhet t’i zhvillojmë, me përjashtim të atyre projektligjeve që do të vijnë të propozuara ose nga Kuvendi, ose nga Këshilli i Ministrave.

Për sa i përket sesionit që lamë pas, komisioni ka kaluar 19 projektligje, për të cilat ishte komision për dhënie mendimi, kemi aprovuar 2 rezoluta në 19 mbledhje të sesionit të kaluar. Sigurisht, janë bërë edhe plot 46 amendime, të cilat kanë pasur si qëllim përafrimin e legjislacionit të të gjitha projektligjeve të propozuara me të gjitha rezolutat, rekomandimet apo me legjislacionin european. Këtu gjej rastin të falënderoj jo vetëm kolegët deputetë të këtij komisioni, të maxhorancës dhe të opozitës, por edhe Departamentin e Përafrimit të Legjislacionit për të gjitha ndërhyrjet me vend të rekomanduara dhe të propozuara në këtë komision. Kemi zhvilluar 11 takime me grupe të ndryshme interesi në lidhje me këto projektligje dhe 2 seanca dëgjimore.

Sigurisht, qëllimi i punës së këtij komisioni ka të bëjë me dy elemente shumë të rëndësishme: me procesin e integritit në Bashkimin European dhe me monitorimin dhe

kontrollin e qeverisë lidhur me ecurinë e pesë prioriteteve, për të vazhduar besoj në të njëjtën linjë edhe në këtë sesion, sidomos duke u fokusuar në këto prioritete: për luftën kundër korrupsionit, luftën kundër krimit të organizuar, reformën në administratën publike, reformën në drejtësi dhe atë për të drejtat e njeriut, të cilat janë çështje prioritare jo vetëm për qeverinë, por edhe për ne, si Kuvend, që t'i monitorojmë, me qëllim që të ecim më tutje në procesin e integritetit europian.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Atëherë, përpara se të fillojmë me shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri - Kosovë 2014-2020, alokimet e vitit 2017” dhe t’ia jap fjalën zotit Skapi, sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, i cili bashkë me zonjat Himçi dhe Shkurtaj janë të pranishëm për të prezantuar këtë projektligj, dua të prek disa pika që i përkasin përsëri punës së Komisionit të Integritetit.

Ne i kemi bërë një kërkesë, në fakt, një letër drejtuar ministrit të Brendshëm, i cili duhet të vijë para komisionit për të na informuar rreth prioritetit numër 4, që ka të bëjë me luftën kundër krimit të organizuar. Ne e kemi bërë disa herë këtë kërkesë dhe ende nuk kemi marrë përgjigje nga ministri i Brendshëm, por maxhoranca kishte shprehur dëshirën për ta marrë përsipër që ta bisedonte me zotin ministër, për shkak se ky është një prioritet shumë i rëndësishëm. Duke pasur parasysh edhe datën e afërt të tetorit, ne duhet të jemi sa më shumë të informuar rreth kësaj pike, sepse në takimet tona që kemi duhet të jemi të informuar për këtë.

Gjithashtu, meqenëse zoti Skapi është i pranishëm, dua t’ju them se ne kemi pasur një mungesë informacioni për planveprimin e Ministrisë së Jashtme për hapat e mëtejshëm që do të marrin në lidhje me 5 prioritetet që Shqipëria do të përmbushë në procesin e integritetit europian. E kemi kërkuar këtë letër prej jush, kemi bërë disa emaille drejtuar ministrit në detyrë dhe nuk kemi marrë akoma një përgjigje. Ju lutem, nëse është e mundur, ta adresoni kërkesën tonë, sepse, sipas rregullave, ne duhet ta kemi në disponim këtë planveprim që të jemi të rakorduar.

Para se kalojmë te projektligji, po jua kaloj juve fjalën.

Andrea Marto – Unë kam një propozim. Duke qenë se mbledhja e datës 16 përkon me fillimin e vitit të ri shkollor dhe shumica e deputetëve janë nëpër zonat e tyre, a mund të realizohet në datën 17 ose në një datë tjetër?

Faleminderit!

Rudina Hajdari – A ka kërkesë tjetër për sa i përket kalendarit?

Taulant Balla– Unë nuk dua të flas për kalendarin, por më shumë për atë që ju ngritët si shqetësim. Ne e mirëkuptojmë axhendën e çdo ministri, por ju kujtojmë se Shqipëria është republikë parlamentare dhe se institucioni më i rëndësishëm në vend është Kuvendi dhe ministri është i detyruar që, nëse nuk është e mundur në atë datë, në datën tjetër pasardhëse duhet të jetë në Kuvend. Këtë qëndrim e kam mbajtur edhe kur kam qenë në opozitë dhe e mbaj edhe tani që jam në maxhorancë. Marrëdhënia e çdo ministri me parlamentin duhet të jetë një marrëdhënie detyruese. Edhe pse sot është prezent sekretari i përgjithshëm për këtë projektligj, duhet të jetë detyrim që prezent të jetë ose ministri ose zëvendësministri, sepse, në fund të fundit, qeverisja është në radhë të parë përgjegjësi politike dhe një përfaqësues i administratës nuk mban përgjegjësi politike. Duke kërkuar mirëkuptimin e kryetares së komisionit, e cila është autoriteti që vendos, dua t'ju them që ky të jetë rasti i fundit që një komision përfaqësohet nga një nivel më poshtë se zëvendësministri.

Faleminderit, zonja kryetare!

Rudina Hajdari – Faleminderit për shqetësimet që shtruat, zoti Balla!

Patjetër që ky është një shqetësim që duhet ta zgjidhni me qeverinë tuaj. Më vjen mirë që jeni dakord me disa nga pikat që unë ngrita, sidomos në lidhje me informacionin që kemi kërkuar nga ministri i Brendshëm.

Për sa i përket përfaqësimit në komision, me zotin Skapi kemi pasur marrëdhënie edhe më parë, sepse kemi qenë kolegë dhe ai i ka të gjitha aftësitë e duhura për të shqyrtuar këtë projektligj, por kjo është gjithashtu një çështje brenda përbrenda dhe çështje administrative dhe do të donim të kishim më shumë përgjigje nga ju, sidomos kur i drejtohem zotit ministër për të na kthyer përgjigje për sa i përket planveprimit dhe gjërave të tjera që kemi kërkuar nga ministria dhe nuk kemi marrë absolutisht asnjë përgjigje. Institucioni i parlamentit duhet të respektohet ashtu siç respektojmë ne punën tuaj.

Zoti Skapi, fjala për ju.

Armand Skapi- E nderuara zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Lidhur me çështjet e përfaqësimit, me mirëkuptimin tuaj, dua t'ju informoj se ministri në detyrë dhe zëvendësministri përgjegjës për çështjet e integritetit europian ndodhen aktualisht jashtë shtetit me një detyrë shtetërore, kështu që e kishin të pamundur të paraqiteshin në komision dhe me autorizimin e tyre jam unë që përfaqësoj institucionin e Ministrisë për

Europën dhe Punët e Jashtme, duke qenë se jemi ne institucioni kompetent në lidhje me këtë marrëveshje.

Duke iu referuar projektligjit, qëllimi i tij është të ratifikojë marrëveshjen e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë , qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit European për programin e veprimit dhe bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri-Kosovë 2014-2020, alokimet për vitin 2017. Marrëveshja e financimit është miratuar në parim nga Këshilli i Ministrave, nëpërmjet vendimit nr.568, datë 03.10.2018. Marrëveshja është nënshkruar për palën shqiptare në datën 23.10.2018 dhe për palën kosovare në datën 31.12.2018. Arsyeja pse procedura e ratifikimit ka nisur në muajin prill të vitit 2019 lidhet me ndryshimet administrative që ndodhen në drejtimin e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme. Megjithatë, ky fakt nuk ka ndikuar në disbursimin e fondeve të vitit 2017, pasi zbatimi i tyre mund të nisë vetëm tre vjet pas vitit përkatës, sipas rregullit $n+3$. Pra, në qoftë se alokimi është i vitit 2017, disbursimi i fondeve mund të kryhet deri në 3 vjet pas përcaktimit të kësaj date, pra të alokimit të vitit 2017. Praktikisht jemi në vitin 2019 dhe jemi brenda afatit 3-vjeçar të paracaktuar.

Alokimet e vitit 2017 për këtë program financohen nga një grant i Bashkimit European nëpërmjet instrumentit IPA II, me një vlerë prej 840 mijë eurosh për të dyja vendet, për Shqipërinë e Kosovën. Nënvizojmë se në total kontributi që do të japë Bashkimi European për zbatimin e përbashkët Shqipëri–Kosovë për periudhën 2014-2020 arrijnë në vlerën 8 milionë e 400 mijë euro, por alokimet e mëtejshme do të jenë subjekt i nënshkrimit të marrëveshjeve të tjera financiare midis vendit tonë, Kosovës dhe Komisionit European. Pra, çdo vit nënshkruhet nga një marrëveshje financiare brenda këtij programi. Ju sjell në vëmendje se tri marrëveshje të tjera janë konkluduar midis këtyre palëve për të njëjtin program për alokimet e viteve 2014-2015, si dhe alokimet e vitit 2016.

Përfitues të këtij programi janë zonat ndërkufitare, si më poshtë:

Për Shqipërinë: qarku i Lezhës dhe qarku i Kukësit, ndërsa në Kosovë është rajoni ekonomik Perëndimor dhe rajoni ekonomik Jugor.

Programi i bashkëpunimit Shqipëri-Kosovë ka si qëllim kryesor të kontribuojë në zhvillimin ekonomiko-social të zonave ndërkufitare dhe të rrisë bashkëpunimin midis vendeve nëpërmjet ndërhyrjeve të përbashkëta.

Gjithashtu, ky program mbështet shkëmbimin e ekspertizës dhe njohurive midis përfituesve, si dhe përmirësimin e politikave publike midis autoriteteve kombëtare, rajonale dhe lokale në zonën e programit.

Duke marrë parasysh aspektet problematike që ndikojnë në ekonominë e zonës dhe zhvillimin e saj të qëndrueshëm, programi do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme tematike.

Prioriteti i parë: mbrojtja e mjedisit, promovimi i politikave të zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, parandalimi dhe menaxhimi i rreziqeve.

Prioriteti dytë: inkurajim i turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore.

Prioriteti i tretë: investim në rini, arsim dhe aftësim.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje financiare do të mundësojë zbatimin e përbashkët të projekteve në të ardhmen midis Shqipërisë dhe Kosovës, sipas prioritetëve të përcaktuara në program, duke u mundësuar në këtë mënyrë aktorëve rajonalë dhe vendorë në të dyja vendet të shkëmbejnë jo vetëm njohuritë dhe përvojat, por edhe të prodhojnë rezultate të dukshme dhe një efekt të matshëm për sektorin socialo-ekonomik.

Në lidhje me evidentimin e problematikave, ashtu si dhe në çdo program tjetër të bashkëpunimit ndërkufitar, problematika kryesore pas miratimit të projektvendimit do të lidhet kryesisht me mundësitë dhe kapacitet përfituese shqiptare për përthithjen, për hartimin e projektpropozimeve dhe për zbatimin me sukses të projekteve të financuara nga ky program.

Në vazhdim, dua të theksoj se puna e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme do të fokusohet në mbështetjen e përfituesve shqiptarë për hartimin dhe zbatimin e suksesshëm të projekteve.

Për sa i përket raportit të vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore, duke qenë se kjo është një ndër arsyet pse projektligji është paraqitur për ratifikim në Kuvend, theksoj se ende nuk mund të shprehem saktësisht në lidhje me efektet konkrete financiare në buxhet, por, duke marrë parasysh se përfitimi financiar i dy vendeve do të jetë përafërsisht i barabartë, pritet që vendi ynë të përfitojë shumën prej 420 mijë eurosh nga nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje.

Theksojmë se përfitues në këtë program nuk do të jenë vetëm institucionet shtetërore buxhetore, por edhe organizata e shoqata të tjera jofitimprurëse, të cilat nuk ndikojnë në të ardhurat dhe shpenzimet buxhetore.

Gjithashtu, sjell në vëmendje se raporti i financimit për çdo projekt, që rezulton nga kjo marrëveshjeje, do të jetë përafërsisht në masën 85%, që financohet nga granti i Bashkimit Europian dhe 15% është financim kombëtar.

Projektet fituese përcaktohen në bazë të vlerësimit të aplikimeve, që dorëzohen nga aplikantët gjatë fazës së thirrjes për projekte dhe propozime.

Dua të theksoj se marrëdhënia kontraktore do të jetë midis përfituesit të projektit dhe Komisionit European, ndërkohë Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme ka si qëllim të koordinojë këtë proces dhe të informojë publikun për shpalljen e këtij programi. Pra, nuk ndikon në vendimmarrjen e përfituesit të projektit, por roli ynë lidhet me informimin e të gjitha subjekteve, që janë të interesuar për përfitimin e të këtyre projekteve dhe për monitorimin e zbatimit. Pjesa e monitorimit financiar i takon Komisionit European.

Nëse keni pyetje ose komente, jemi të hapur për t'ju dhënë përgjigje.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Skapi, për prezantimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Republikës së Kosovës dhe Komisionit European, për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri-Kosovë 2014-2020, alokimet e vitit 2017”!

Dua t’ia jap fjalën zotit Kasneci, drejtor i Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit.

Zoti Kasneci, fjala është për ju.

Dedë Kasneci – Faleminderit, zonja kryetare!

Projektligji, nuk synon të përafrojë ndonjë akt të veçantë të legjislacionit të Bashkimit European, por, pavarësisht kësaj, ky projektligj është në përputhje me legjislacionin e Bashkimit European në fushën e veprimit të projektligjit. Konkretisht, me nenet 110, 112 dhe 113 të MSA-së BE-Shqipëri, të cilat parashikojnë bashkëpunimin për zhvillimin rajonal dhe vendor mes palëve, si dhe mundësinë që Shqipëria të përfitojë nga Bashkimi European një ndihmë financiare në formë granti dhe huaje.

Gjithashtu, kjo marrëveshje është në përputhje me nenin 8 të marrëveshjes kuadër, që Shqipëria ka lidhur me Bashkimin European në vitin 2015 për zbatimin e programit e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, si dhe me seksionin 8 dispozitat për programet e bashkëpunimit ndërkufitar të kësaj marrëveshjeje. Gjithashtu, është në përputhje me nenin 2, pika 1, germa “a, nënpika 3, të rregullores IPA II, që parashikon se ndihmat e BE-së, që do të japë në kuadër të IPA II, përfshijnë mbështetje për reformat politike nëpërmjet bashkëpunimit rajonal dhe marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë.

Gjithashtu, projektligji është në përputhje me nenin 3, pika 1, germa “a” dhe në pikën 4 të kësaj rregulloreje, që parashikon se asistencë e BE-së në fushën e bashkëpunimit rajonal dhe territorial, mund të financojë në veçanti veprime që përfshijnë shumë vende, si dhe veprime të bashkëpunimit ndërkufitar, transkombëtar dhe rajonal.

Së fundi, ky projektligj është në përputhje me nenin 6, pika 4, të rregullores zbatuese të miratuar nga Komisioni European për zbatimin e rregullores IPA II, që parashikon se një marrëveshje e vetme financimi për programet e bashkëpunimit ndërkufitar mund të nënshkruhet nga të gjitha vendet pjesëmarrëse në një program specifik.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Kasneci!

Kalojmë te pjesa e pyetjeve.

A ka pyetje nga anëtarët e Komisionit?

Para se të fillojmë me pyetjet e anëtarëve të komisionit, po e filloj unë me një pyetje. Zoti Skapi, ju thatë se ky plan, kjo marrëveshjeje, ka filluar që në vitin 2014, pra që është aprovuar nga Bashkimi European dhe po aplikohet që prej vitit 2014. Sot ne po bëjmë ratifikimin e alokimit të financave për vitin 2017.

Dua të di, meqenëse ju thatë se pjesë e punës suaj është edhe monitorimi i këtij procesi, çfarë rezultatesh ka sjellë ky projekt deri tani? Pra, çfarë keni parë deri tani në lidhje me fushat, objektivat që synon ky projektligj?

Faleminderit!

Armand Skapi - Faleminderit, zonja kryetare!

Dua të theksoj se në kuadër të programit IPA 2014-2020 janë bërë dy thirrje për aplikime për projekte dhe ka qenë një shifër e konsiderueshme kërkesash, gati 96 kërkesa, nga të cilat janë përzgjedhur vetëm 5. Kjo për shkak se kaq kanë qenë fondet në dispozicion, po përveç kësaj edhe cilësia e paraqitjes së projektit. Pra, le të themi se interesi për të aplikuar në lidhje me financimin e këtyre projekteve ka qenë shumë i madh, gjë që dëshmon rolin që ka luajtur Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme në lidhje me sensibilizimin e opinionit publik, të institucioneve, po edhe të shoqërisë civile, për paraqitjen e aplikimeve për projekte.

Nga këto, siç e thashë më lart, janë miratuar pesë projekte ndërkufitare, mes të cilave nxitja e zhvillimit të rinjve dhe punësimit, nëpërmjet akademive ndërkufitare të ndërmarrësisë dixhitale Lezhë dhe Prizren. Projekti i dytë lidhet me fuqinë punëtore, kualifikimin për integrimin ekonomik. Projekti i tretë është edukimi i hapur mbi teknologjinë. Projekti i katërt është përmirësimi i ofertës turistike në zonat malore të Shqipërisë dhe Kosovës. Projekti i pestë është zgjerimi “Via Dinarika” në rajonet e bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri – Kosovë.

Faktikisht, mund të themi se është ende herët për një vlerësim të rezultateve konkrete të këtyre projekteve, sepse faza e vlerësimit kërkon njëfarë kohe. Normalisht, për programin 2014 – 2020, faza e vlerësimit mund të shkojë deri në vitin 2023.

Në qoftë se mund t’u referohemi projekteve të mëparshme, mund të themi se ka pasur një rezultat pozitiv nga financimi i projekteve IPA Shqipëri-Kosovë për periudhën 2010 – 2013, për projektin “Ndërtojmë së bashku një rajon tërheqës dhe të begatë”, vlera e të cilit ishte 2, 5 milionë euro. Partner për palën shqiptare ishte qarku i Kukësit, ndërsa për palën kosovare ishte komuna e Dragashit.

Mendojmë s ky ka qenë një rezultat suksesi, pasi u mundësua rehabilitimi i rrugës kryesore në pikën doganore Shishtavec-Krushehtë, deri në rrugën Krajkollog – Shishtavec. Faza e dytë ishte rikonstruksioni i rrugëve brenda në fshatin e Shishtavecit, me gjatësi 2, 2 kilometra në total.

Pra, këto projekte që financohen nga IPA mund të ofrojnë jo vetëm ekspertizë teknike, por në bazë të interesit të zonës ndërkufitare mund të përfshijnë edhe projekte investimi.

Në këtë mënyrë, ne mendojmë se ky ka qenë një rezultat suksesi. Ndërkohë, për periudhën 2014 – 2020 vlerësimi do të kërkojë njëfarë kohe, derisa të mbyllet krejtësisht projektet. Vlerësimi financiar do të bëhet nga ana e Komisionit Europian, sepse si financues, i takon atij ta bëjë këtë fazë vlerësimi, ndërkohë që ne si institucion, bëjmë vlerësimin e rezultateve konkrete në praktikë të projekteve. Pra, është ende herët për të bërë një vlerësim të kësaj faze.

Rudina Hajdari – Faleminderit për përgjigjen, zoti Skapi!

Ka pyetje ndokush tjetër?

Po, zoti Gjoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ralf Gjoni – Më e bukura është se më jepet mikrofoni i kryetarit të Grupit të Partisë Socialiste për të shprehur një shqetësim këtu.

Faleminderit, zonja kryetare!

Ju falënderoj, zoti Skapi!

Tani, unë do të doja të dija nëse ju si ministri keni marrë masa konkretisht për të parë fizibilitetin e këtij projekti. Ju folët në lidhje me një projekt specifik për punësimin e të rinjve në të dyja anët e kufirit, por kuptohet, përgjegjësia jonë si shtet dhe përgjegjësia juaj si ministri e deleguar për implementimin dhe monitorimin e këtij projekti, është për territorin e Shqipërisë.

Meqë qenka ende herët për të monitoruar rezultatet e prekshme të këtij projekti në terren, çfarë masash keni ndërmend të ndërmerrni ju si institucion? Konkretisht, çfarë ekipi monitorues keni parashikuar, për të monitoruar efektet reale të këtij projekti? Po flasim për rajonin e Kukësit, një nga qarqet më problematike sa i përket punësimit të të rinjve, për një rajon me një papunësi tmerrësisht të lartë, për një qark tepër problematik për sa i përket ikjes dhe largimit të njerëzve.

Pyetja është edhe e përgjithshme, duke marrë shkas nga ky projekt: Këto projekte e këto grante që jepen nga Bashkimi European, a kanë efekte, në eksperiencën tuaj si diplomat? A keni ndërmarrë ju një iniciativë në institucionin tuaj, për të diskutuar edhe me kolegët tuaj europeanë, në Delegacionin e Bashkimit European këtu në Tiranë, për sa i përket rritjes së efikasitetit dhe prekshmërisë së këtyre projekteve?

Pra, thënë shkurt e qartë: hidhen miliona euro nga Bashkimi European, por nuk e merr vesh njeri se ku shkojnë. Ndërkohë, ju si institucion ngarkoheni me përgjegjësinë për të monitoruar fizibilitetin e këtyre projekteve. Pra, çfarë masash keni ndërmarrë ju konkretisht për ta monitoruar këtë projekt?

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit, zoti Gjoni!

Fjala është për ju, zoti Skapi!

Armand Skapi – Faleminderit për pyetjen, zoti Gjoni!

Në lidhje me projektin e miratuar tashmë, që citova më lart, nxitja e punësimit të të rinjve, ku përfitues janë Lezha dhe Prizreni, dëshiroj të theksoj se data e fillimit të projektit është 15 mars 2018, dhe projekti ka një kohëzgjatje prej njëzet e tetë muajsh. Pra, është një projekt në vazhdim, me një vlerë prej 575, 984 euro, mbi gjysmë milionë euro.

Në lidhje me monitorimin e zbatimit të këtij projekti, unë e përmenda se monitorimi financiar bëhet nga vetë Komisioni European, si financues, ndërkohë që ne si institucion, pas zbatimit të projektit, jo vetëm në rastin konkret po në çdo rast, kryejmë vizita në terren dhe intervistojmë të gjitha subjektet përfituese të financimit, si dhe subjekte të tjera, të cilat mund të kenë pasur ndikim nga ky projekt. Pra, ne e kryejmë atë testimin në terren, nuk është se marrim informacion nga qendra. Vizitën në terren e bëjmë jo vetëm për marrjen e informacionit dhe se si është zbatuar, por kryesisht për informimin përpara thirrjes ose gjatë thirrjes për aplikim në mënyrë që të ketë një pjesëmarrje sa më të gjerë në procesin e paraqitjes së aplikimeve.

Për pjesën e vlerësimit të asistencës teknike të Bashkimit Europian, ju me shumë të drejtë e ngrini si çështje, sepse gjithmonë është ngritur si shqetësim me të drejtë, që kjo asistencë e konsiderueshme nga pikëpamja financiare ku shkon? Ne e dimë që kryesisht shkon për asistencë teknike nëpërmjet ardhjes së ekspertëve të huaj, organizimit të trajnimeve, por në disa raste nuk ka shkuar pikërisht aty ku ne si institucion kemi synuar. Vitet e fundit, të paktën për aq kohë sa unë kam qenë i përfshirë në këtë proces, ne kemi synuar që asistencë të shkojë pikërisht në ato raporte direkte që ne kemi me Bashkimin Europian, aty ku ne e kemi më të nevojshme.

Faza e trajnimeve dhe e vizitave studimore ka kaluar, kështu që kemi kërkuar asistencë për përgatitjen e dokumenteve strategjike dhe informuese që ne u paraqesim strukturave të Bashkimit Europian në mënyrë të tillë që ato të paraqiten në mënyrën që vetë këto struktura i kërkojnë. Pra, jo ne të bëjmë filozofi se si mund ta kërkojë Komisioni Europian, por asistencë ka kërkuar pikërisht që të fokusohemi në mënyrën se si do ta paraqesim veten përpara Komisionit Europian.

Ne kemi pasur edhe raste ku i kemi refuzuar ekspertët, të cilët nuk i kemi konsideruar të përshtatshëm qoftë për institucionet tona apo qoftë për institucionet e tjera, të cilat përfitojmë asistencë teknike nga arsye nga më të ndryshme, qoftë nga *background*-i apo efektiviteti që ai mund të japë gjatë ekspertizës së tij. Kryesisht kemi kërkuar ekspertizë nga ato shtete, të cilat e kanë kaluar para nesh fazën e integritetit dhe kanë një asistencë më të freskët në këtë drejtim. Ky është një proces që vazhdon.

Rudina Hajdari – Faleminderit, për përgjigjet shteruese!

A ka ndonjë gjë tjetër?

Nuk ka.

Fjalën e ka nënkryetarja e komisionit.

(Diskutime pa mikrofon)

Senida Mesi – Sadri, një pyetje kam.

Është e disata herë që në këtë komision po trajtojmë apo aprovojmë marrëveshje të tilla jo vetëm në kuadrin IPA, por që në njëfarë mënyre kanë edhe bashkëpunim të fondeve IPA me qeveritë e tjera, gjithmonë në kuadër të integritetit në Bashkimin Europian.

Ka një numër shumë të madh aplikimesh, kjo sigurisht që është përgjegjësi e Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, jo vetëm njoftimi, por edhe eksperiencat e mira nga vitet e mëparshme. Në fakt, unë e di këtë çështje, sepse kam marrë vetë pjesë në disa trajnime para disa kohësh, në lidhje me shkrimin e projekteve. Nëse kanë shprehur interes 96 shoqata,

individë apo janë bërë 96 aplikime dhe janë shpallur vetëm 5 fitues dhe nëse kriteri ka qenë vetëm shuma në dispozicion, atëherë jemi në rregull, por nëse te ky selektim ka pasur edhe elemente të tjera apo shuma në dispozicion mund të ketë qenë shumë më e madhe, por projektet që kanë kaluar çdo sitë të procesit të vlerësimit kanë vetëm 5, kjo është shqetësuese.

Është shqetësuese, sepse në fund të ditës kërkesa është e madhe, nuk dinë të shkruajnë projekte, projektet nuk janë në linjë me kushtet dhe kriteret e Bashkimit Europian. Ju e dini më mirë se për të shkruar një projekt brenda territorit të Shqipërisë është një çështje, për të shkruar një projekt me donatorët e tjerë është çështje tjetër dhe për të shkruar një projekt me donatorët e Bashkimit Europian është histori më vete.

Ne si përfaqësues të Kuvendit kemi për detyrë të informojmë, t'i kërkojmë llogari ministrisë, si dhe të japim mbështetje maksimale në lidhje me proceset që janë thjesht informuese, por edhe trajnuese. Nëse ministria juaj së bashku me fondet e tjera merr përsipër të bëjnë edhe trajnimin e shoqërisë civile, të universiteteve, të grupimeve apo shoqatave të ndryshme, sikurse mund të jenë shoqatat e biznesit, të zejtarisë, të prodhuesve e të tjera, me qëllim që ato jo vetëm thjesht të njohin procesin, por edhe të dinë të shkruajnë projekte, unë e vlerësoj maksimalisht që ne të arrijmë, nuk mund ta quaj elitë, në një shtresë ku shoqëria civile është në gjendje t'i absorbojë sa më shumë këto fonde. Nëse sot nuk jemi në gjendje t'i absorbojmë fondet IPA, pyetja ime është se çfarë do të vijë nesër në momentin e hapjes së negociatave me fondet e kohezionit që janë shumëfish më të mëdha sesa fondet e paraksesimit me qëllim që jo vetëm shoqëria civile, por rajonet e veçanta dhe bashkitë të jenë në gjendje të shkruajnë projekte, por të jenë edhe fitues?

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Zoti Skapi, e ka fjalën.

Armand Skapi – Faleminderit, zonja nënkryetare për pyetjen!

(Diskutime pa mikrofon)

Senida Mesi – Pyetja ime ishte: çfarë mund të bëjë ministria që të trajnojë sa më shumë njerëz dhe që të thithin sa më shumë...?

(Diskutime pa mikrofon)

Ralf Gjoni – Zoti Abazi, a mund ta bëjmë rolin tonë si deputetë. Nëse nuk doni të rriini në komision, çohuni dhe dilni jashtë.

Sadri Abazi – Pse, do të pyes ty unë?

Ralf Gjoni – Patjetër.

Sadri Abazi – Meqë ti vetë ke qenë pjesë e asaj shoqate, do të bëhet...

Ralf Gjoni – Duhet të respektoni kolegët...

Sadri Abazi – Do të ndërhyj sa herë të flasësh.

(Diskutime pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Kjo është detyra juaj kryesore. Ju jeni deputet dhe anëtar i Komisionit të Integritetit. Çfarë detyre tjetër keni përveç kësaj? A përfaqësoni popullin, a je anëtar i këtij grupi?

(Diskutime pa mikrofon)

Nëse nuk keni durim, mund të çoheni dhe të largoheni...

Sadri Abazi – Këtu nuk më ke sjellë ti...

(Diskutime pa mikrofon)

Nëse ti i kërkon Komisionit European pse ka tenderuar 5 veta dhe nuk ka tenderuar 90, kjo është punë tjetër...

(Diskutime pa mikrofon)

Senida Mesi – Nuk e bën ministria tenderin?

Sadri Abazi – Atëherë çfarë përgjigje do të japë përfaqësuesi i ministrisë?

Senida Mesi - A e keni të qartë pyetjen time...?

(Diskutim pa mikrofon)

Armand Skapi - Nëse mund të vijoj me dhënien e përgjigjes, institucioni ynë, çdo vit që hapet thirrja për alokimin e fondeve sipas programit IPA 2014-2020, përveçse bën thirrje publike nëpërmjet faqeve *online* dhe shkuarjes në terren, në kuadrin e këtij programi janë përcaktuar disa pika fokale nëpër rajone të ndryshme të vendit, të cilat japin të gjithë asistencën informuese dhe rekomandime se si mund të hartojmë projekte. Institucionit tonë nuk i lejohet të hartojë projekte ose të ndikojë në hartimin e projekteve nga ana e aplikuesve, sepse është në shkelje të rregullave të Bashkimit European.

Ne kemi vijuar me fushatën tonë informuese nëpërmjet dhënies së modeleve më të mira në hartimin e këtyre projekteve. Kanë qenë 96 propozime të paraqitura nga të cilat janë miratuar 5, por duhet të theksoj se këto 5 projekte përfituese kanë pasur 2 partnerë: Shqipërinë dhe Kosovën, pra është projekt shqiptaro-kosovar. Së pari.

Së dyti, këto projekte kanë ezauruar mbi 95 % të fondit të alokuar, pra le të themi se ai fond i alokuar për projekte është ezauruar nga këto 5 projekte, sepse ka qenë edhe mundësi financiare.

Gjithashtu, është e vërtetë që cilësia e projekteve nuk është në nivelin e dëshiruar dhe ne kemi bërë përpjekjen maksimale jo vetëm nëpërmjet informimit sa herë që janë bërë thirrjet,

por jo më larg se vitin e kaluar më 17 janar 2018, ne kemi bërë një konferencë kombëtare ku kemi mbledhur të gjitha subjektet shtetërore dhe joshetërore, si dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, ku kemi informuar për programin IPA dhe përfitimet që vijnë nga projektet që do të financohen nga ky program.

Gjithashtu, ne administrojmë një listë shumë të gjerë të të gjithë aplikuesve potencialë, që mund të jenë institucione qendrore, lokale, po ashtu edhe përfaqësues të shoqërisë civile, të cilët i mbajmë vazhdimisht të informuar për mënyrën se si financohen projektet IPA, që është Bashkimi European që përzgjedh, por duke dhënë modele më të mira që i ndjekin edhe vendet e tjera që përfitojnë nga këto projekte, ne përpiqemi të rrisim shkallën e pranueshmërisë së projekteve të miratuara nga Komisioni European.

Faleminderit!

Rudina Hajdari - Faleminderit, zoti Skapi, për përgjigjen tuaj!

Më lejoni të sqaroj diçka: fakti që ne kemi të tilla debate, ka të bëjë edhe me cilësinë e deputetëve dhe kjo është një gjë që nuk shmanget dot.

Për t'u rikthyer edhe një herë te pika e parë që ngriti edhe kolegu tjetër, zoti Balla, patjetër ne nuk kemi asgjë me ju, por ne duhet të respektojmë institucionin, duhet të respektojmë parlamentin dhe parlamenti më shumë se kurrë duhet të respektohet sot. Ju lutem, kjo nuk duhet të kthehet më në precedent, që të kemi përfaqësues, të cilët nuk janë në nivelin e duhur për të na dhënë përgjigje. Kemi absolutisht besim te puna juaj, ju keni një eksperiencë të gjatë në diplomaci dhe jemi shumë të nderuar që keni ardhur sot, por është një çështje teknike që kërkojmë ta respektoni.

Ju faleminderit!

Kalojmë te miratimi nën për nen i dy neneve.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Këtu e mbylлим këtë projektligj.

Lidhur me miratimin e kalendarit, projektligjin "Për ndryshimet klimatike" nga data 16 e shtymë për datën 17.

Ka ndonjë propozim tjetër lidhur me kalendarin?

Senida Mesi - Do të propozoja që po në datën 17 t'i bënim thirrje edhe Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme për dëgjuesë në lidhje me raportin dhe pjesën e ecurisë.

Rudina Hajdari – Ne i kemi bërë dy kërkesa ministrit të Jashtëm dhe atij të Brendshëm për dëgjuesë në lidhje me prioritetet 3 dhe 4, por sidomos prioritetit 4, që lidhet me luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Do të donim t'ia rikujtojmë këtë ministrit të Brendshëm, sepse zotit Skapi sapo ia thamë.

Faleminderit të gjithë anëtarëve!

Ju uroj një ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA